



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Të Drejtat e Personave nën Mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës

Ky material është përgatitur nga Qendra A.L.T.R.I në kuadër të projektit “***Kontribimi në Përmirësimin e Standardeve të të Drejtave të Njeriut brenda dhe jashtë Sistemit të Burgjeve në Shqipëri***” i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në partneritet me Fondacionin Qendra Evropiane në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij dokumenti pasqyron pikëpamjet e autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian

Tiranë 2021

Të Drejtat e Personave nën Mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës

Shërbimi i Provës është organ përgjegjës për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe urdhërimeve të prokurorit për:ⁱ

- mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative,
- të masave të shmangies nga ndjekja penale,
- të dënimeve jo me burgim për të miturit, ose veprimtarive të tjera sipas akteve të tjera ligjore,
- si dhe trajtimin e individualizuar të nevojave dhe aftësive të personit nën mbikëqyrje për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Ny punim sjell në vëmendje dhe trajton standardet në nivel kombëtar (sipas legjislacionit shqiptar) dhe në nivel ndërkombëtar (sipas akteve ligjore të Këshillit të Europës dhe Kombeve të Bashkuara) mbi të drejtat e personave nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës. Punimi është ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë përcakton standardet për alternativat e dënimeve me burgim, ndërkohë që pjesa e dytë përmban standardet e mbikëqyrjes e personave të dënuar me dënime alternative nga Shërbimi i Provës. Në të dy pjesët e trajtuara, fokus i veçantë u kushtohet parimeve bazë dhe të drejtave të personave të dënuar me dënime alternative.

1. Alternativat e dënimeve me burgim

Alternativat e dënimeve me burgim janë dënime të cilat kryhen në komunitet dhe jo në izolim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Qëllimi i masave alternative të dënimit me burgim, është gjetja e alternativave efektive ndaj dënimit me burgim për të dënuarit dhe të mundësojë autoritetet t'i përshtatin sanksionet penale me nevojat individuale të të dënuarit dhe në proporcionalitetin e duhur me veprën penale të kryer. Aspektet pozitive të këtyre dënimeve janë se e lejojnë të dënuarin të mbetet i lirë duke i mundësuar të vazhdojë punën, studimet dhe jetën në familje. Megjithatë, këto masa alternative mund të jenë subjekt i kushteve dhe kufizimeve, shkelja e të cilave mund të çojë, në raste serioze, edhe në dënim me burgim.ⁱⁱ

Alternativat e dënimeve me burgim sipas **Kodit Penal**ⁱⁱⁱ janë:^{iv}

- a) Gjysmëliria;
- b) Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove;
- c) Qëndrimi në shtëpi.

a) Gjysmëliria: Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për: ^v

- punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional,
- përgjegjësitë thelbësore familjare apo
- për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor.

Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata.^{vi}

b) Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë: Gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale, për shkak të:^{vii}

- rrezikshmërisë së paktë të personit,
- moshës,
- kushteve shëndetësore apo mendore,
- mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën,
- rrethanave të kryerjes së veprës penale,
- si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale.

I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:^{viii}

- të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional;
- shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare;
- të riparojë dëmin civil të shkaktuar;
- të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara;
- të mos frekuentojë vende të caktuara;
- të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike;
- të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara;
- të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale;
- të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë;
- mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues;
- t'i nënshtrohet një trajtimi apo programi mjekësor ose rehabilitimi, me qëllim që të ndalojë përdorimin e alkoolit ose lëndëve narkotike.

Qëndrimi në shtëpi: Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:^{ix}

- për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të;
- për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të;
- për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut;
- për personat mbi 60 vjeç, që janë të paafte nga ana shëndetësore;
- për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësie familjare.

Në nivel ndërkombëtar, Kombet e Bashkuara kanë përcaktuar standardet minimale për masat alternative të dënimit me burgim, që njihen si “*Rregullat e Tokios*”^x. të cilat paraqesin një set rregullash me qëllim nxitjen e përdorimit të dënimeve alternative me burgim dhe garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave minimale të personave të cilët u nënshtrohen këtyre dënimeve. Në mënyrë të përmblodhur parashikohen **standarde të tilla si:**^{xi}

- Masat alternative të dënimit duhet të përdoren në përputhje me parimin e ndërhyrjes minimale.
- Përdorimi i dënimeve alternative duhet të jetë pjesë e lëvizjes drejt depenalizimit dhe dekriminalizimit në vend që të ndërhyjë ose të vonojë përpjekjet në atë drejtim.
- Përzgjedhja e një dënimi alternativ do të bazohet në një vlerësim të kriterëve të vendosura në lidhje me natyrën dhe peshën e veprës dhe personalitetin, prejardhjen e të dënuarit, qëllimet e dënimit dhe të drejtat e viktimave.
- Për dënimet alternative që vendosin një detyrim ndaj të dënuarit, të zbatuara para ose në vend të procedurave zyrtare ose gjyqimit, duhet të kërkohej pëlqimi i të dënuarit.
- I dënuari ka të drejtë të bëjë një kërkesë ose ankesë për zbatimin e dënimeve alternative tek një organ gjyqësor ose në një autoritet tjetër të pavarur kompetent për çështje që prekin të drejtat e tij individuale.
- Dinjiteti i të dënuarit duhet të mbrohet në çdo kohë.
- Në zbatimin e dënimeve alternative, të drejtat e të dënuarit nuk duhet të kufizohen më shumë sesa ishte autorizuar nga autoriteti kompetent që dha vendimin fillestar.
- Duhet të respektohen e drejta e jetës private dhe e drejta e privatësisë së familjes të të dënuarit.
- Kohëzgjatja e një dënimi alternativ nuk duhet të kalojë periudhën e caktuar nga autoriteti kompetent në përputhje me ligjin.
- Të dënuarit duhet, kur është e nevojshme, të pajisen me ndihmë psikologjike, sociale dhe materiale dhe me mundësi për të forcuar lidhjet me komunitetin dhe për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

2. Mbikëqyrja e personave të dënuar me dënime alternative nga Shërbimi i Provës

Shërbimit i Provës në Shqipëri është organi shtetëror i cili mbikëqyr dhe mbështet zbatimin e dënimeve alternative, si dhe ka si mision promovimin e **përfshirjes shoqërore të personave nën mbikëqyrje**, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë ndaj shoqërisë dhe viktimës nëpërmjet rregullave të ndërveprimit social dhe ndërhyrjeve të posaçme.^{xii}

Shërbimi i Provës rregullohet nga ligji specifik Nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës” dhe Rregullorja “Për Organizimin e Funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për Përcaktimin e Standardeve e të Procedurave, për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të Dënimeve Alternative”.

Në realizimin e veprimtarisë së tij dhe mbrojtjen e të drejtave të personave nën mbikëqyrje, Shërbimi i Provës udhëhiqet nga disa parime të rëndësishme ku mund të përmendim:^{xiii}

- **të drejtat dhe liritë themelore të njeriut garantohen** në mënyrë të ligjshme dhe sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut;
- ndërhyrjet e Shërbimit të Provës duhet të jenë **proporcionale** dhe të nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj dhe në vendimin gjyqësor;
- mjetet dhe masat e përdorura të kufizojnë sa më pak të drejtat e personit nën mbikëqyrje dhe familjes së tij dhe të jenë në proporcion me nevojën që ka diktuar vendosjen e tyre;
- trajtimi i barabartë dhe **mosdiskriminimi** i personave nën mbikëqyrje;
- transparenca dhe komunikimi në një gjuhë të kuptueshme përmes një përkthyesi zyrtar, nëse personi nuk flet apo nuk kupton gjuhën shqipe dhe në mënyrë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;
- **respektimi i jetës private** të personit nën mbikëqyrje dhe familjes së tij, duke e kufizuar atë vetëm kur është e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik, ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave të tjerë;
- ruajtja e konfidencialitetit për informacionin e krijuar dhe të administruar për shkak të funksionit me qëllim **mbrojtjen e të dhënave personale**;
- **respektimi i dinjitetit dhe integritetit të personit nën mbikëqyrje, të familjes së tij, të viktimës së veprës penale dhe të familjes së saj.**

Parimet e renditura më lart përkthehen në garanci dhe të drejta për personat nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës.

I dënuari ka, ndër të tjera, edhe të drejtën e **ankimit administrativ** kundër veprimeve të punonjësit të Shërbimit të Provës si dhe **ankimit tek prokurori apo gjykata** për aktet e nxjerra nga shërbimi i provës që kanë të bëjnë me çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimit penal të dhënë ndaj tij.^{xiv}

Përsa i përket **standardeve në nivel evropian** mbi veprimtarinë e Shërbimit të Provës në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të personave nën mbikëqyrjen, **Këshilli i Europës**, në rekomandimin Rec(2010)1 “Mbi Rregullat e Shërbimit të Provës”^{xv} ka përcaktuar këto standarde:^{xvi}

- Agjencitë e Shërbimit të Provës **respektojnë të drejtat e njeriut të personit në mbikëqyrje.**
- Të gjitha ndërhyrjet e tyre duhet të kenë vëmendjen e duhur **për dinjitetin, shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e shkelësve.**
- Në të gjitha rastet kur merren me çështje që lidhen me viktimat e krimit, ata duhet të respektojnë të drejtat dhe nevojat e tyre.
- Duhet **të marren parasysh plotësisht karakteristikat individuale, rrethanat dhe nevojat e shkelësve** në mënyrë që të sigurojnë që secila çështje të trajtohet me drejtësi.
- Ndërhyrjet e Shërbimit të Provës **do të kryhen pa diskriminim** në bazë të shkaqeve të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, paaftësia, orientimi seksual, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, shoqërimi me një grup etnik pakicë, pronë, lindja ose statusi tjetër.
- Shërbimi i Provës nuk duhet të vendosë ndonjë barrë ose kufizim të të drejtave mbi shkelësin më të madh se sa është e parashikuar nga vendimi gjyqësor ose administrativ.
- Duhet të kërkohet pëlqimi dhe bashkëpunimi i shkelësve për rastet e ndërhyrjeve që i prekin ata.

- Çdo ndërhyrje, para se të vërtetohet përfundimisht fajësia, duhet **të jetë pa paragjykuar prezumimin e pafajësisë**.

Po ashtu, nëse u rikthehemi sërish **Rregullave të Tokios**^{xvii} të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara, në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të dënimeve alternative, theksohet se:^{xviii}

- qëllimi i mbikëqyrjes është të zvogëlojë mundësinë e përsëritjes së veprimit kriminal dhe të ndihmojë integrimin e shkelësit në shoqëri në një mënyrë që minimizon gjasat e një kthimi në krim;
- mbikëqyrja për një dënim alternativ duhet të kryhet nga një autoritet kompetent sipas kushteve specifike të përshkruara me ligj, i cili duhet të marrë parasysh:
 - nevojat e shoqërisë dhe
 - nevojat dhe të drejtat e kryerësit të veprës penale dhe viktimës;
- të drejtat e të dënuarit nuk duhet të kufizohen më shumë sesa ishte autorizuar nga autoriteti kompetent që dha vendimin fillestar;
- në çdo rast duhet të mbrohet dinjteti i të dënuarit dhe të rrespektohet e drejta e jetës private dhe familjare të të dënuarit.

ⁱ Ligji Nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Për më tepër shiko linkun vijues:

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200702104127Ligj%20nr.%2079,%20dt.%2025.6.2020.pdf>.

ⁱⁱ *Manual për Punonjësin e Shërbimit të Provës*, 2014 (ribotim), botim i Prezencws sw OSCE nw Shqipwri, faqe 65; link:

http://www.sherbimiproves.gov.al/images/pdf/Manuali_Punonjesit_SHP_2014.pdf.

ⁱⁱⁱ Bwhet fjalw pwr Kodin Penal tw Republikës së Shqipërisë: ligj nr. 7895, datw 27.1.1995, i ndryshuar; link:

<https://qbz.gov.al/previeë/a2b117e6-69b2-4355-aa49-78967c31bf4d>

^{iv} Për më tepër shih Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, nenet 58, 59 dhe 59/a.

^v Po aty, neni 58.

^{vi} Po aty.

^{vii} Po aty, neni 59.

^{viii} Po aty, neni 60.

^{ix} Po aty, neni 59/a.

^x Bëhet fjalë për: Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për dënimet alternative (Rregullat e Tokios) [*United Nations Standards for Minimum Rules for Non-custodial Measures (The Tokyo Rules)*], miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/110 të 14 Dhjetorit 1990, link:

<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/TokyoRules.aspx>.

^{xi} Për më tepër shih: Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për dënimet alternative (Rregullat e Tokios), link:

<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/TokyoRules.aspx>.

^{xii} Ligji Nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të Provës”, neni 5. Linku për të aksesuar materialin: <https://ëëë.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200702104018ligj%20nr.%2078,%20dt.%2028.6.2020.pdf>

^{xiii} Ligji Nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës”, neni 4.

^{xiv} Po aty.

^{xv} Bëhet fjalë për: Rekomandimi CM/Rec(2010)1 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare mbi Rregullat e Provës të Këshillit të Evropës. Linku për të aksesuar materialin:

https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cfbc7 .

^{xvi} Po aty.

^{xvii} Bëhet fjalë për: Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për dënimet alternative (Rregullat e Tokios) [*United Nations Standards for Minimum Rules for Non-custodial Measures (The Tokyo Rules)*], miratuar nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/110 të 14 Dhjetorit 1990, link:

<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/TokyoRules.aspx>.

^{xviii} Po aty, pikat 3, 10 e 12.